



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

VENDIM

Nr. 19, dt. 21.12.2022

MBI MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE, KLASIFIKIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË FUNKSIONARËVE TË ZGJEDHUR E TË EMËRUAR DHE TË PUNONJËSVE TË ADMINISTRATËS TË KËSHILLIT TË QARKUT PËR VITIN 2023

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit “Për Buxhetin e Vitit 2023”, Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, Ligjit nr 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, VKM-së nr.625 dt.28.09.2022, për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.165 dt.02.03.2016 të Këshillit të Ministrave, “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar, të nëpunësve civile e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar, si dhe vendimit të Këshillit të Qarkut nr. 7 date 26.04.2017 “Mbi miratimin e nivelit të ri të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civile e të punonjësve të administratës të Këshillit të Qarkut”, me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut

VENDOSI

1. Të miratojë Strukturën organizative dhe klasifikimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar dhe të punonjësve të administratës të Këshillit të Qarkut për vitin 2023 sipas tabelës bashkangjitur.
2. Efektet financiare do të përballohen brenda fondit të pagave të miratuar për vitin 2023.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Sektori i financës, zhvillimit ekonomik shërbimeve, burimeve njerëzore dhe zhvillimit të teritorit
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga dt. 01.01.2023.

Konceptoi: O.Beqiraj
Juristi: Gj.Kristo
Sek: B.Muco

Kryetari i Këshillit të Qarkut

Ana VERUSHI



**STRUKTURA ORGANIZATIVE E ADMINISTRATËS TË
KËSHILLIT TË QARKUT PËR VITIN 2023**

V.K.M.625 dt 28.09.2022 Për disa shtesa e ndryshime ne vendimin 165 dt. 02.03.2016 te Keshillit te Ministrave "Për grupimin e njësive të veteqeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionareve të zgjedhur e të emruar, të nepunesve civile e të punonjësve administrative të njësive të qeverisjes vendore"

Nr.	Njësia strukturore	Nr punonjësve	Niveli Lidhja 7	Paga Gr, sipas Kat.diplom	Paga e grupit	Vjetërsi 2%	Paga e pozicionit	Statusi I punonjesit
I	Kryetar i Këshillit të Qarkut	1	I/e				150000	Të zgjedhur
II	Zvendëskryetar i Këshillit të Qarkut	1	1/e				101650	Të zgjedhur
III	Sekretar i Këshillit të Qarkut	1	I-b	1	14000	2%	93000	Të emruar K Qarkut
IV	Kabineti i Kryetarit							
	Drejtor i Kabinetit të kryetarit - Keshilltar juridik	1	I-b	1	14000	2%	105000	Pozicion pune me kontratë
	Keshilltar i mardhenieve me publikun dhe mediat	1	II-b	1,2	14000/11000	2%	79000	Pozicion pune me kontratë
	Keshilltar per Projektet e Bashkimit European	1	II-b	1,2	14000/11000	2%	85000	Pozicion pune me kontratë
	Zedhenes i zyres se Kryetarit dhe sherbime te tjera	1	III-b	1,2	14000/11000	2%	57000	Pozicion pune me kontratë
V	Spektori i finances, zhvillimit ekonomik, sherbimeve, burimeve njerezore dhe zhvillimit te territorit							
	Pergjegjes i Sektorit te Finances dhe Buxhetit	1	III-a/1	1	14000	2%	74700	Pozicion pune shërbimi civil
	Specialist i nivelit të lartë për Shërbimet, Burimet Njerezore dhe Emergjencat Civile	1	III-b	1,2	14000/11000	2%	65200	Pozicion pune shërbimi civil
	Specialist i nivelit të lartë për Urbanistikën dhe Zhvillimin e Teritorit	1	III-b	1,2	14000/11000	2%	65200	Pozicion pune shërbimi civil
	Specialist I nivelit te larte per programet e zhvillimit	1	III-b	1,2	14000/11000	2%	65200	Pozicion pune shërbimi civil
	Specialist per Shendetsine dhe Ceshtje: sociale, arsimin dhe Kulturen	1	III-b	1,2	14000/11000	2%	65200	Pozicion pune shërbimi civil
	Shofer autoveture I institucionit	1	P.19/20			1%	41700	Pozicion pune me kontratë
	Totali Administrata	13						

Kryetar i Këshillit të Qarkut





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT KORÇË

RELACION

***MBI MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE, KLASIFIKIMIN E NIVELIT
TË PAGAVE TË FUNKSIONARËVE TË ZGJEDHUR E TË EMËRUAR DHE TË
PUNONJËSVE TË ADMINISTRATËS,
TE KËSHILLIT TË QARKUT PËR VITIN 2023***

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit “PërBuxhetin e Vitit 2023”, Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, Ligjit nr 7961 datë 12.07.1995 “Kodi I Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, VKM-së nr.625 dt.28.09.2022, për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.165 dt.02.03.2016 të Këshillit të Ministrave, “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar, të nëpunësve civile e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”si dhe vendimit të Këshillit të Qarkut nr. 7 date 26.04.2017 “Mbi miratimin e nivelit te ri te pagave te funksionarëve të zgjedhur e te emëruar, të nëpunësve civile e të punonjësve të administrates të Këshillit të Qarkut”, i propozojmë Këshillit të Qarkut miratimin e strukturës organizative të Administratës të Këshillit të Qarkut, si dhe rikonfirmimin e nivelit të pagave për vitin 2023.

Struktura organizative nuk ka pësuar ndryshime që nga miratimi i fundit i saj në mbledhjen e Keshillit të muajit Qershor të këtij viti.

Niveli I pagave gjithashtu nuk ka pesuar ndryshime të tjera që nga miratimi I tij në mbledhjen e Këshillit të muajit Tetor të këtij viti.

Mbi bazën e këtyre niveleve janë llogaritur edhe fondi I pagave dhe sigurimeve shoqërore, të cilat janë parashikuar në buxhetin e Këshillit të Qarkut për vitin 2023.

Sa më sipër paraqesim për miratim strukturën organizative dhe klasifikim e nivelit të pagave të funksionareve të zgjedhur dhe të emëruar si dhe të punonjësve të administratës së Këshillit të Qarkut për vitin 2023 sipas tabelës bashkëngjitur.

Korçë me 05.12.2022

Oljona Beqiraj
Përgjegjëse Finance